

Emri i Lëndës : Teori dhe Qasje në Mësimdhënie dhe Nxënie

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
EDU 413	B	Vjeshtë	3.00	1.00	0.00	3.50	6.00

Lektori	Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.
Asistenti	
Gjuha e kursit	Anglisht
Niveli i lëndës	Master
Përshkrimi	Në këtë kurs studentët do të njihen me teoritë tradicionale të të nxënit dhe ndikimin e tyre në mësimdhënie. Ata do të eksplorojnë qasjen bihevoriste, zhvillimin kognitiv të Piaget, teoritë e të mësuarit shoqëror dhe konstruktivizmin. Studentët gjithashtu do të studiojnë teori bashkëkohore të të nxënit, të tilla si të nxënit me bazë zhvillimet në neuroshkencë, të mësuarit të bazuar në probleme dhe koncepte, si dhe teoritë e ndryshme të inteligjencës. Ata do të eksplorojnë sesi konceptet kryesore të perspektivave teorike mbështesin dhe ndikojnë të nxënit dhe zhvillimin e një individi.
Objektivat	Në këtë këndë studentët pritet: Të njihen me teoritë kryesore të të nxënit dhe parimet e tyre. Të kuptojnë dhe ndërgjegjësohen për mënyrat se si këto parime mund të zbatohen në mësimdhënie. Të demonstrojnë se si qasjet teorike të të nxënit dhe njohjes lidhen me menaxhimin e klasës, mësimdhënien dhe me zhvillimin e çdo individi. Të zhvillojnë dhe përforcojnë mendimin kritik, prezantimet me gojë dhe aftësinë e të shkruarit. Të praktikojnë mësimdhënie që përshtatet me nevojat e nxënësve.
Konceptet Kryesore	Teoritë e të nxënit, bihejviorizmi, konjitivizmi dhe zhvillimi konjitiv, konstruktivizmi dhe ndërveprimi, motivimi dhe emocionet, teoritë e inteligjencës, të menduarit kritik dhe konceptet, taksonomia e Blumit dhe hartimi i objektivave dhe rezultateve të të nxënit, ndryshimet individuale dhe mënyra e të nxënit,

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Prezantimi i lëndës, objektivave të saj dhe mënyrës së vlerësimit. Koncepti i të nxënit dhe të mësuarit. Si ndodh procesi i të nxënit, faktorë dhe dimensione që përfshihen në këtë proces (Illeris, ch1, Prichard, ch1)
2	Teoritë bihejvioriste të të nxënit. Kushtëzimi klasik i Pavlovit. Kushtëzimi operant i Skinnerit. Shpjegimet e tyre për të nxënin. Aplikimet e këyre ideve në Edukim. (Prichard, ch 2, Taylor, ch 3)
3	Teoritë konjitive të të nxënit. Të nxënit si process konjitiv. Elementit dhe faktorët që lehtësojnë të nxënin. Teoria e Piazhësë për zhvillimin konjitiv dhe ndikimi i saj në edukim. Teoria e përpunimit të informacionit. (Illeris ch9, Prichard, ch 3, Taylor, ch 2)
4	Taksonomia e Blumit për objektivat e të nxënit. Përgatitja e objektivave të një lënde dhe ore mësimi bazuar në taksonominë e Blumit. Gjashtë nivelet e zhvillimit të njohurive dhe vlerësimi i tyre. (Krauthwohl, 2002)
5	Teoritë sociale të të nxënit. Teoria e Vigockit për rolin e ndërveprimit dhe socializimit në të nxënë dhe aplikimi i saj në kontekstin e edukimit në shkollë. Aftësitë sociale dhe zhvillimi i tyre. Teoria e Bandurës për të nxënin me anë të vëzhgimit. Roli i mësuesit në zhvillimin e aftësive sociale (Illeri, ch16, Taylor, ch 6)
6	Konstruktivizmi, parimet e të nxënit sipas kësaj teorie. Teoria e krijimit të skemave dhe shtimi i dijes së re në dijen ekzistuese. Të nxënit bazuar në situata dhe dhe veprimtari të lidhura me jetën reale. Aplikime i teorive në mësimdhënie. (Illeris, ch3, Prichard, ch 3)
7	Një model konstruktivist i të nxënit: Teoria e të nxënit eksperimental (Të Nxënit Konceptiv. Të Menduarit Kritik dhe me anë të zgjidhjes së problemeve. Kolb & Kolb, 2009)

8	Provimi gjysmefinal
9	Mësimdhënia dhe të Nxënit e Bazuar në zhvillimin e trurit Struktura, Memoria, Ruajtja dhe Transferimi i të nxënit. (Prichard, ch 7) Si ndikojnë emocionet dhe motivimi në procesin e të Nxënit. Implikimet në orën e mësimin. (Taylor ch 2, Illeris ch10)
10	Të nxënit bazuar në koncepte, mendimi kritik dhe zgjidhjen e problemeve. Çfarë janë konceptet? Si mësohen ato. Modele të ndryshme për mësimin e koncepteve. Rëndësia e zhvillimit të mendimit kritik: analizimi, sintetizimi dhe vlerësimi kritik i informacionit, strategji për zhvillimin e mendimit kritik. Të mësuarit përmes zgjidhjes së problemeve. (Taylor, ch 11—12)
11	Emocionet dhe motivimi, roli i tyre në të nxënë. Llojet e motivimit dhe ndikimi i tyre. Si mund të rritet motivimi te nxënësit. Roli i emocioneve dhe ndjenjave në të nxënë. Roli i mësuesit në përdorimin e këtyre faktorëve në klasë. (Taylor ch 2, Illeris ch 10, 12)
12	Teoritë e Inteligjencës: Teoria e Inteligjencës së Shumëfishtë. (Gardner). Llojet e inteligjencave dhe strategjitë e të mësuarit sipas secilit lloj. Rëndësia e njohjes së mësuesit me këtë teori dhe aplikimi i saj në klasë. (Illeris ch9, Prichard, ch 4, Taylor ch 10,)
13	Teoritë e Inteligjencës: Inteligjenca Emocionale. Aspektet kryesore të kësaj inteligjence dhe rëndësia e saj për rregullimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve ndërpersonale. Rëndësia e saj në kontekstin edukativ. (Prichard, ch 4, Taylor ch 10)
14	Ndryshimet individuale. Ekzistenca e mënyrave të ndryshme të të mësuarit. Mënyrat dhe Preferencat e të Nxënit. Strategjitë që përdor secili tip/lloj.Ndikimi i tyre në mësimdhënie. Probleme dhe vështirësi që hasen gjatë të nxënit. Njohja e mësuesit me këto vështirësi dhe menaxhimi i tyre në klasë. (Illeris, 7 Prichard, ch 5-6, Taylor, 16)
15	Prezantimet e studentëve
16	Provim Final
Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • Illeris, K. (2018). Contemporary theories of learning: Learning theorists...in their own words. 2nd edition. Taylor & Francis Routledge.
Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • Pritchard, A. (2009). WAYS OF LEARNING: LEARNING THEORIES AND LEARNING STYLES IN THE CLASSROOM. London: Routledge. • Taylor, R. G.; MacKenney, L. (2008). IMPROVING HUMAN LEARNING IN THE CLASSROOM, THEORIES AND TEACHING PRACTICES. New York : Rowman & Littlefield Education. • Krathwohl. D.R. (2002). A revision of Bloom's taxonomy. Source: Theory Into Practice , Autumn, 2002, Vol. 41, No. 4, pp. 212-218
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të jetë në gjendje të përshkruajë parimet themelore të të mësuarit dhe zhvillimit njerëzor.
2	Të demonstrojë njohuri mbi teoritë kryesore të të nxënit dhe mësimdhënies
3	Të kuptojë teoritë e motivimit dhe inteligjencës dhe zbatimin e tyre në klasë
4	Të zbatojë parimet bazë të të nxënit dhe mësimdhënies në një sërë situatash edukative
5	Të gjenerojë një filozofi personale të edukimit dhe të nxënit duke analizuar dhe reflektuar mbi parimet kryesore të teorieve të të nxënit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	35	
Kuize	0	0	
Projekte	1	10	
Projekte semestrare	1	15	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		60	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		40	
Total		100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	2	6	12
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			148
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.92
ECTS			6.00